




Aksesi në Ujë dhe Kanalizime në Vendbanimet Informale dhe Zonat Rurale të Pesë Rrethëve të Shqipërisë duke përfshirë Sarandën, Gjirokastrën, Lezhën, Pogradecin dhe Vlorën.

Objektivi

Objektivi i projektit është përgatitja e dy studimeve në lidhje me aksesin në ujë dhe kanalizime: njëri në zonat urbane informale të 5 qyteteve Saranda, Gjirokastra, Lezha, Pogradeci, dhe Vlora si dhe tjetri në zonat rurale përreth këtyre qyteteve.

Në çdo qytet ky studim:

- Identifikon vendndodhjen gjeografike të vendbanimeve joformale urbane, duke përfshirë ato që kanë dalë kohët e fundit, si rezultat i procesit të migrimit nga zonat rurale drejt atyre urbane,
- Vlerëson madhësinë e popullsisë në vendbanimet joformale,
- Qartëson pozicionin formal të çdo vendbanimi informal në përputhje me ligjin "Legalizimi dhe Rregullimi i Vendbanimeve Joformale në Shqipëri" i 2006-ës.
- Sigurimi i informacionit nga bashkitë si dhe nga njësitë e licensuara të ujit lidhur me çështje të aksesit në ujë dhe kanalizime,
- Hartimi dhe zhvillimi i një ankete në një shkallë të vogël dhe intervistave fokus grup me banorë të zonave informale duke mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore



Në zonat urbane informale u zhvilluan 200 intervista ndërsa në ato rurale 700 intervista. Madhësia e mostrës u përcaktua duke supozuar se për një nivel besueshmërie 95%, 50% e popullatës që jeton në këto zona nuk ka akses në shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Kjo mostër është shpërndarë në proporcion me numrin e popullsisë së zonave informale dhe bashkive të zgjedhura, duke siguruar një përqindje të lartë përfaqësuese të popullsisë që jeton në këto zona rurale.

Në vazhdim, IKU zhvilloi 12 diskutime në fokus grup, një për çdo rreth duke patur si referenc zonat rurale ndërsa për çdo qytet kishin si referenc vendbanimet informale.

Raporti dokumentoi çështje sociale dhe mjedisore, si dhe gjithashtu dha rekomandime mbi mënyrat eficiente

dhe mjetet e nevojshme për të siguruar akses në shërbimet ujore dhe kanalizime.

FAKTET KRYESORE

DONATOR:

UNDP & Enti Rregullues i Ujit në Shqipëri

KOHËZGJATJA:

Mars 2012 – Gusht 2012

PËRFITUESIT:

- Pogradeci
- Lezha
- Vlora
- Saranda
- Gjirokastra

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Tirana, Shqipëri
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.